



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 127 Prot.

Tiranë, më datë 25.02.2022

**VENDIM**  
**Nr. 37, datë 25.02.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.02.2022:

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimarrjes për projektin kërkimor shkencor “Amfiteatri i Durrësit, 2021”, me drejtues projekti Prof. As. Dr. Eduart Shehi (Instituti i Arkeologjisë) dhe Prof. Stephan Schmid (Universiteti Humboldt) dhe plotësimet si vijojnë:
  - a. Projekti i propozuar duhet të jetë në harmoni dhe përputhje me parashikimet e Planit të Menaxhimit të Integruar të zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit (PMI), i cili është ende në proces vendimarrje;
  - b. Sondazhi nr. 1 pranë hyrjes veriore në brendësi të arenës, të sillet me dimensione të reduktuara sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 259 datë 13.12.2017 të K.K.A. “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kreun III të Rregullores së Arkeologut”;
  - c. Sondazhi nr. 2 i propozuar pranë mureve të periudhës osmane jashtë Amfiteatrit, të plotësohet me dokumentacionin përkatës për pronësinë e zonës ku parashikohet ndërhyrja dhe me dakordësinë paraprake me Bashkinë Durrës.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

KRYETAR  
Elva MARGARITI

